

VENDIM
Nr.116, datë 13.2.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET KFW FRANKFURT AM MAIN, (KFW), DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË, (PËRFITUESI), PËR FINANCIMIN SHITESË
PËR PROGRAMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA, RAJONI
VLORË, (KËSTI II), RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.75/2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet KfW Frankfurt am Main, (KfW), dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Përfituesi), për financimin shtesë për programin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, rajoni Vlorë, (kësti II), ratifikuar me ligjin nr.75/2017, me një grant në shumën 5 424 266.79 (pesë milionë e katërqind e njëzet e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e nëntë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE NDRYSHUESE

DATE 16.12.2019 E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT TË DATËS 15 DHJETOR 2016
 (“MARRËVESHJA FILLESTARE E FINANCIMIT”) NDËRMJET KFW, FRANKFURT
 AM MAIN (“KFW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, E PËRFAQËSUAR NGA
 MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË (“PËRFITUESI”) PËR FINANCIM
 SHITESË PREJ 5,424,266.79 EURO
 - MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA TRANSHI II –
 (RAJONI VLORË)
 BZM – Nr. 2016.6790.6

Përmbajtja

Seksioni 1 – Përkufizime

Seksioni 2 – Ndryshime të marrëveshjes fillestare të financimit

Seksioni 3 – Përfshirja e termave

Seksioni 4 – Hyrja në fuqi

Angazhimet e pajtueshmërisë së përfituesit

Angazhimet e pajtueshmërisë së agjencisë zbatuese të projektit

Bazuar në notën verbale të datës 24.10.2019 nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Përfituesi dhe KfW–ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme ndryshuese (“Marrëveshja ndryshuese”):

Seksioni 1 **Përkufizime**

Përveç në rast të ndonjë dispozite të shprehur për të kundërtën në këtë marrëveshje ndryshuese apo në rastet kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në Marrëveshjen Fillestare të Financimit kanë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2 **Ndryshime të Marrëveshjes Fillestare të Financimit**

2.1 Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes Fillestare të Financimit ndryshohen si më poshtë:

a) Fjalja e parë e nenit 1.1 hiqet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja do t'i japë Përfituesit një kontribut financiar deri në 12,959,129.25 EURO

b) Neni 1.2 hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

Në këtë Program Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë vepron si Njësia e Koordinimit të Programit (ose NjKP) nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUIM). Përfituesi, nëpërmjet NjKP-së, do të përdorë apo do të garantojë që Bashkia e Vlorës (Agjencia e Zbatimit të Projektit apo AZP-ja) të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për:

- i. rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese,
- ii. infrastrukturën (riciklim, ndarje, kompostim),
- iii. pajisjet për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe
- iv. Konsulentin e Zbatimit

(Programin) dhe kryesisht për të paguar kostot e këmbimeve valutore. NjKP-ja, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë, e cila do të bashkënenëshkruhet nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

c) Neni 3.2 hiqet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 31.12.2023 apo ndonjë datë tjetër për të cilën të dyja palët mund të bien dakord.

d) Paragrafi i parë i nenit 8.1 (Publikimi dhe transferimi i informacionit që ka lidhje me Programin hiqet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“Në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacione të përzgjedhura (duke përfshirë rezultatet e kategorizimit dhe vlerësimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit pas zbatimit) për Programin dhe financimin e tij gjatë bisedimeve para-kontraktuale, ndërsa vazhdon zbatimi i marrëveshjes(eve) që lidhet/lidhen me programin dhe gjatë fazës pas-kontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë).”

e) Neni 9.1 deri 9.2 (Dispozita të Ndryshme) hiqet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“Përfituesi, nëpërmjet NjKP-së, garanton se do të respektojë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 1 (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Përfituesit). Përfituesi, nëpërmjet NjKP-së, do të garantojë që AZP të respektojë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 2 (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).”

2.2 Shtojcat e Angazhimeve të Pajtueshmërisë bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese do të bashkëlidhen si shtojca të reja dhe do të jenë pjesë integrale e Marrëveshjes Fillestare të Financimit.

2.3 Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes Fillestare të Financimit nuk do të ndryshojnë.

Seksioni 3

Përfshirja e Termave

Dispozitat e nenit 5 (Kostot dhe pagesat publike), neneve 6.1 dhe 6.2 (Deklarimet kontraktuale dhe përfaqësimi) dhe neneve 9.3, 9.4, 9.5, 9.6 (Dispozita të ndryshme) të Marrëveshjes Fillestare të Financimit do të përfshihen në këtë Marrëveshje Ndryshuese, sikur të jenë përcaktuar plotësisht në këtë Marrëveshje Amendimi dhe sikur referencat në këto klauzola të (Marrëveshjes) apo “kësaj Marrëveshjeje” të jenë referenca për këtë Marrëveshje Ndryshuese.

Seksioni 4

Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje Ndryshuese nuk do të hyjë në fuqi derisa KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Përfituesit për përfundimin e procedurave që duhet të përmbushen nga Përfituesi.

Bërë në 2 (dy) origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
në datën 10. 12. 2019

KfW

CONSTANZE KREISS

Head of Division

JOSHEN REIK

Project Manager

Tiranë,

në ditën 16 të dhjetorit 2019

Republika e Shqipërisë,

ANILA DENAJ

Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

SHTOJCË

MARRËVESHJA E PËRPUTHSHMËRISË PËRFITUESI

MARRËVESHJA E PËRPUTHSHMËRISË AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTTIT

Shtojca 1

1. PËRKUFIZIME

Praktika Shtrenguese: dëmtimi apo cenimi, ose kërcënimi për të dëmtuar apo cënuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person apo pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme veprimet e një personi.

Praktikë e Fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e cila hartohet për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktika Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi apo kërkimi drejtpërdrejt apo tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme apo avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilido person, me qëllim ndikimin e veprimeve të çdo personi apo shkaktimin e përmbajtjes së çfarëdo personi nga çfarëdo veprimi.

Praktika Mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin, që me vetëdije apo pakujdesi mashtron apo përpiket të mashtrojë një person për të marrë një përfitim financiar apo për të shmangur një detyrim.

Praktika Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi apo fshehja e dëshmive materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin apo kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, apo Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrenguese apo Praktikë të Fshehtë, apo kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i cilitdo personi për ta penguar atë, të zbulojë informacionet e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin apo ndjekjen e hetimit, apo (ii) çdo veprim që ka për qëllim të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW -së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrenguese apo Praktikë të Fshehtë.

Person: çdo person fizik, ent ligjor, partneritet apo shoqëri e pa themeluar.

Praktikë e Sanksionueshme: çdo Praktikë Shtrenguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese apo Praktikë Penguese (siç janë përcaktuar këto terma këtu), e cila (i) është e paligjshme sipas ligjit Gjerman apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, dhe (ii) e cila ka, apo potencialisht mund të ketë, një efekt ligjor material apo reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimit të saj.

Organi Sanksionues: cildo prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Sanksionet: ligjet për sanksionet ekonomike, financiare apo tregtare, rregulloret, embargot apo masat shtrenguese të administruara, të miratuara apo të zbatuara nga cildo Organ Sanksionues.

Lista e Sanksioneve: çdo listë me persona, grupe apo ente të caktuara specifikisht, të cilët i nënshtrohen sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Përfituesi

a) do vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjithë informacionet që kanë lidhje me “njihni klientin tuaj” apo informacione të ngjashme për Përfituesin ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) nëpërmjet NjKP, t'i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet në lidhje me Programin dhe dokumentet e Përfituesit dhe të palëve të tij (nën) kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, të cilat janë të nevojshme për KfW-në për të përmbushur detyrimet e saj në mënyrë që të parandalojë çdo praktikë të sanksionueshme, pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Përfituesin, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) nëpërmjet NjKP, të informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo vihet në dijeni apo dyshon për çfarëdo praktikë të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit që ka lidhje me Programin;

d) nëpërmjet NjKP, t'i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Programin dhe ecurinë e mëtejshme të tij, siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) nëpërmjet NjKP, t'i mundësojë KfW-së dhe agentëve të saj në çfarëdo lloji kohe, të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër të Përfituesit dhe të palëve të tij (nën) kontraktuese dhe të palëve të tjera, që ka lidhje me Programin dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet që kanë lidhje me të për qëllime të kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman apo ligjin e vendit të Përfituesit, Përfituesi përfaqëson se asnjë nga Personat të cilët veprojnë në lidhje me Programin në emër të Përfituesit nuk ka kryer apo nuk është i angazhuar në asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia të parashtruara në këtë nen kryhen për herë të parë nga përfshirja e kësaj shtojce në këtë Marrëveshje. Do të konsiderohet që të përsëritet mbi çdo tërheqje të kontributit financiar duke iu referuar rrethanave që dominojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJA POZITIVE

Përfituesi merr përsipër, sapo Përfituesi apo KfW-ja vihen në dijeni apo dyshojnë për çdo Praktikë të Sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave apo financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Përfituesi do të përgjigjet menjëherë dhe me hollësi të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW-ja dhe do të sigurojë mbështetje dokumentare për një përgjigje të tillë me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Përfituesi nuk do të kryejë asnjë transaksion, as nuk do të angazhohet në asnjë aktivitet tjetër në lidhje me Programin që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

Shtojca 2

Angazhime të pajtueshmërisë së Agjencisë Zbatuese të Projektit

1. PËRKUFIZIME

Praktika Shtrenguese: dëmtimi apo cënimi, ose kërcënimi për të dëmtuar apo cënuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person apo pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme veprimet e një personi.

Praktika e Fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e cila hartohet për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktika Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi apo kërkimi drejtpërdrejt apo tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme apo avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilido person, me qëllim ndikimin e veprimeve të çdo personi apo shkaktimin e përmbytjes së çfarëdo personi nga çfarëdo veprimi.

Kategori të caktuara shkeljesh: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve të përcaktuara sipas Rekomandimeve të FATF dhe shënimet interpretuese përkatëse: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe mashtrimi/shantazhi; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve; shfrytëzimi seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimin e paligjshëm të armëve; trafikimin e paligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të mallrave të tjera; korrupsioni dhe ryshfeti; mashtrimi; falsifikimi i monedhave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja; lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme dhe marrja peng; grabitja apo vjedhja; kontrabanda (duke përfshirë atë në lidhje me doganat dhe akcizat dhe taksat); krimet tatimore (që kanë lidhje me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi; pirateria; tregtimi i paligjshëm në bursë dhe manipulimi i tregut.

Rekomandimet e FATF -së: rekomandime të tilla siç përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimet Financiar (FATF). FATF është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktika Mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije apo nga pakujdesia mashtron apo përpiket të mashtrojë një person për të marrë një përfitim financiar apo për të shmangur një detyrim.

Origjina e Paligjshme: origjina e fondeve të përfituara nëpërmjet

- a) çdo shkelje të listuar në Kategoritë e Përcaktuara të Shkeljeve;
- b) çdo Praktikë Korruptive;
- c) çdo Praktikë Mashtruese; apo
- d) pastrimit të parave.

Praktika Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi apo fshehja e dëshmive materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin apo kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, apo Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrenguese apo Praktikë të Fshehtë, apo kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i cilitdo personi për ta penguar atë, të zbulojë informacionet e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin apo ndjekjen e hetimit, apo (ii) çdo veprim që ka për qëllim të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrenguese apo Praktikë të Fshehtë.

Person: çdo person fizik, ent ligjor, partneritet apo shoqëri e pa themeluar.

Praktikë e Sanksionueshme: çdo Praktikë Shtrenguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese apo Praktikë Penguese (siç këto terma janë përcaktuar këtu), e cila (i) është e paligjshme sipas ligjit Gjerman apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, dhe (ii) e cila ka, apo potencialisht mund të ketë, një efekt ligjor material apo reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së apo zbatimit të saj.

Sanksionet: ligjet për sanksionet ekonomike, financiare apo tregtare, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese të administruara, të miratuara apo të zbatuara nga cilido organ sanksionues.

Organi Sanksionues: cilido prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Lista e Sanksioneve: çdo listë me persona, grupe apo ente të caktuara specifikisht, të cilët i nënshtrohen Sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Agjencia Zbatuese e Projektit

a) do vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjithë informacionet që kanë lidhje me “njihni klientin tuaj” apo informacione të ngjashme për Përfituesin apo çdo aksionar (direkt apo indirekt), organ vartës dhe/apo çdo filial (nëse ka), ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) t'i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet në lidhje me Programin dhe dokumentet e Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe të palëve të saj (nën) kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, të cilat janë të nevojshme për KfW-në për të përmbushur detyrimet e saj në mënyrë që të parandalojë çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë Zbatuese të Projektit, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) të informojë KfW-në , menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo vihet në dijeni apo dyshon për çfarëdo Praktikë të Sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit nga Agjencia Zbatuese e Projektit, çdo anëtar apo organ menaxhues i saj apo çdo aksionar i saj;

d) t'i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Programin dhe ecurinë e mëtejshme të tij, siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllimet e kësaj shtojce;

e) t'i mundësojë KfW-së dhe agjentëve të saj në çfarëdo lloj kohe, të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër të Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe të palëve të saj (nën) kontraktuese dhe të palëve të tjera, që ka lidhje me Programin dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet që kanë lidhje me të për qëllime të kësaj shtojce.

f) të informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, për çdo ngjarje që rezulton në cilindo prej Agjencisë Zbatuese e Projektit, cilindo anëtar të organeve menaxhuese ose organeve të tjera drejtuese apo cilindo prej aksionarëve të saj, që ëshë apo bëhet shtetas i caktuar në mënyrë të posaçme, person i bllokuar apo ent që ruhet në çfarëdo liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman apo ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë Zbatuese të Projektit, Agjencia Zbatuese e Projektit përfaqëson dhe garanton se sa vijon është e vërtetë dhe korrekte:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Zbatuese e Projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj.

b) Sipas njohurive të saj më të mira dhe vetëm në lidhje me aksionarët e njohur për Agjencinë Zbatuese të Projektit, në vijim të rregullave që zbatohen për tregun e bursës, as kapitali i Agjencisë Zbatuese të Projektit, as fondet e investuara në Program nuk janë me origjinë të paligjshme.

c) Asnjë nga Agjencia Zbatuese e Projektit, filialet e saj, degët e saj apo çdo Person tjetër në emër të saj apo të tyre nuk ka kryer apo nuk angazhohet në asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk: i) ka hyrë në asnjë marrëveshje biznesi me shtetas të caktuar në mënyrë të posaçme, persona të bllokuar apo ent që ruhet në çdo listë sanksionesh; apo ii) është angazhuar në asnjë lloj aktiviteti tjetër që do të përbënte një shkelje të sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e parashtuara në këtë nen bëhen për herë të parë me përfshirjen e kësaj Shtojce në këtë Marrëveshje Amendimi. Ato do të konsiderohen se do të përsëriten në çdo tërheqje të kontributit financiar duke iu referuar rrethanave që dominojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJA POZITIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër:

a) të jetë në përputhje të plotë me standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF, dhe të zbatojë, ruajë dhe, nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e saj të brendshme (duke përfshirë pa kufizim në lidhje me verifikimin e duhur të klientit,) të përshtatshëm për të shmangur çdo Praktikë të Sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia Zbatuese e Projektit apo KfW-ja vihen në dijeni apo dyshojnë për çdo Praktikë të Sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Agjencia Zbatuese e Projektit do përgjigjet menjëherë dhe me hollësi të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW-ja dhe të japë mbështetje dokumentuese për një përgjigje të tillë kur kërkohet nga KfW-ja.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër:

a) të garantojë se kapitali i saj dhe fondet e tjera të cilat ajo investon nuk do të jenë me origjinë të paligjshme;

b) të garantojë se biznesi i saj nuk do çojë në asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) të mos lidhë apo vazhdojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas të caktuar në mënyrë të posaçme, persona të bllokuar ose ent që mbahet në ndonjë listë sanksionesh dhe nuk do të angazhohet në asnjë lloj aktiviteti tjetër që do të përbënte një shkelje të sanksioneve.